

OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE DHE TË RINJVE

Newsletter nr.15, Dhjetor 2018

“SHKOLLA SI NJË KUNDËRSHTARE E VIJËS SË PARË TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM”

Qëllimi kryesor:

Parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm duke angazhuar shkollat si institucione kryesore të vijës së parë.

Objektivat:

- Përmirësimi i kapaciteteve të shkollës për t'u angazhuar në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm.
- Formimi i konceptit kundër ekstremizmit të dhunshëm për 600 nxënës të shkollave dhe pjestarë të komunitetit.

Zonat e projektit: Kamëz, Elbasan dhe Pogradec

Kohëzgjatja: Shkurt – Nëntor 2018

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në kuadër të skemës së granteve të vogla të projektit "Fuqizimi i Shoqërisë Civile në rritjen e Rezistencës së Rinisë ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm" financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Terre des Hommes Albania në partneritet me ISD, CCG dhe Universitetin Bedër, është duke zbatuar projektin "*Shkolla si një kundërshtar e vijës së parë të Ekstremizmit të Dhunshëm*".

Gjetjet, sfidat, praktikat e mira dhe rezultatet

Gjetjet:

- Nxënësit informohen për fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm (EDH) kryesisht nëpërmjet internetit, medias sociale dhe televizionit. Kjo sipas rezultateve të testimit nëpërmjet përdorimit të disa pyetsorëve të shkurtër.
- Nga aktivitetet rezultoi se ndihet nevoja e trajtimit me nxënësit dhe prindërit e temave në lidhje me format e shfaqjes së EDH dhe faktorët që e nxisin atë.
- Bashkëpunimi i shkollës me institucionet vendore si policinë, qeverisjen vendore, OJQ-të lokale ishte i dukshëm por ka ende punë për të bërë



- Pjesmarrja e prindërve në aktivitete ishte e ulët megjithë përpjekjet për t'i bërë të interesuar dhe t'i përfshirë.
- Nga testimet e shkurtëra të realizuara gjatë debateve publike, në lidhje me njohjen dhe besimin në institucionet vendore, rezultoi që nxënësit përsa i përket institucioneve vendore njihnin dhe besonin më shumë Bashkinë dhe Policinë.
- Programet e institucioneve të cilat nxënësit i njohin ose kanë më shumë njohuri janë: arsimi gjithëpërfshirës, policimi në komunitet, shkollat qendër komunitare, barazia gjinore dhe harmonia e paqja fetare.
- Nxënësit në fund të aktiviteteve morën njohuri për sjelljet antishoqërore si bulizmi dhe nga testimi i bërë rezultoi që e kanë më të njohur konceptin dhe llojet e tij. Gjithashtu toleranca si koncept dhe të drejtat e njeriut janë tashmë më të njohura por që duhet punuar ende në këtë drejtim.
- Raportimi nga nxënësit në shkollë i rasteve të sjelljeve antishoqërore në përgjithësi ndjek rrugën mësues kujdestar – psikolog – drejtuesi i institucionit.
- Roli i grupit psiko – social në shkollat pilot nuk ndihet sa duhet përsa i përket rasteve të sjelljeve të antishoqërore. Kjo ndoshta edhe për shkak të ngarkesës së tyre.
- Shkollat pilote nuk mbajnë evidencë për rastet e sjelljeve antishoqërore, llojet e tyre dhe faktorët që i nxisin ato.
- Në përgjithësi shkollat e injorojnë, minimizojnë ose e quajnë inekzistente shfaqjen e sjelljeve antishoqërore e veçanërisht bulizmit ndonëse ai po bëhet gjithnjë e më i pranishëm në shkolla.
- Gjatë aktivitete të realizuara u vu re që mësuesit e shkollave e njohin pak ose aspak udhëzuesin e UNESCO-s për mësuesit në lidhje me parandalimin e EDH, i publikuar në faqen zyrtare të IZH-ës.

Sfidat:

- Shkollat në përgjithësi duke mos qenë qendër komunitare janë më të përqëndruara në zbatimin e programit mësimor se sa në problematikat komunitare e në veçanti të EDH.
- Në fillimet e aktiviteteve si rezultat i përdorimit të disa pyetësorëve të shkurtër u vu re shkalla e ulët e informimit të nxënësve për fenomenin e EDH, format e shfaqjes së tij dhe faktorët që e nxisin. Për rjedhje është e nevojshme informimi përmes edukimit në shkollë.
- Burimi i informacionit mbi fenomenin e EDH për nxënësit rezultoi që ishte kryesisht interneti, media sociale dhe televizioni. Shkolla duhet të jetë pararojë në dhënien e informacionit për të mos lejuar dizinformimin, marrjen e informacioneve të pakontrolluara dhe jo të sakta nga nxënësit.
- Në organizmin e aktiviteteve në shkollën “Ibrahim Rugova” në Kamëz ekzistonte vështirësia që krijonte fakti që në këtë shkollë mësimi zhvillohej në 2 turne.

Praktikat e mira:

- Bashkëpunimi i shkollës së mesme “Dëshmorët e Pojskës” në Hudënisht të Pogradecit me institucionet vendore është një shembull që duhet ndjekur nga shkollat e tjera.



- Realizimi i 1 vidio për bulizmin (nërmjet aktrimit të një rasti) nga nxënësit e shkollës së mesme “Ibrahim Rugova” gjë e cila është shprehje jo vetem e njohjes së fenomenit por edhe e mbajtjes së një qendrimi kritik ndaj tij.
- Nxënësit duke konfirmuar rritjen e shkallës së njohurive të tyre mbi EDH dhe aftësive të tyre krijuese realizun një sërë materialesh gjatë zbatimit të projektit si; fletëpalosje, postera, fotomontazh dhe esse te ndryshme mbi dhunën bulizmin, barazinë gjinore, tolerancën në përgjithësi dhe atë fetare në veçanti.
- Koordinatorët e aktiviteteve (pranë shkollave) treguan aftësi të mira organizative dhe krijuese në kryerjen e aktiviteteve dhe inkurajimin e aktivizimit të studentëve.
- Në shkollën e mesme “Mahmud dhe Ali Cungu” në Elbasan edhe pas mbarimit të aktiviteteve të projektit u krijua në ditët e para të muajit Dhjetor nga vetë nxënësit klubi i i parë i debatit për ekstremizmin e dhunshëm. Ngritja e klubit u njoftua në fb. e shkollës <https://www.facebook.com/100022438453459/posts/353026408788638/> si dhe u publikua në fb. e Observatorit https://www.facebook.com/pg/observator.org.al/posts/?ref=page_internal

Rezultatet:

Gjatë zbatimit të projektit u realizuan 18 aktivitete si më poshtë

- 3 trajnime 1-ditore
- 12 debate publike
- 3 fushata ndëgjegjësuere 1-ditore

Përfituesit:

Përfitues direkt në total **484** (nxënës, mësues, prindër dhe pjestarë të komunitetit). Përfitues indirekt në total **13750** persona (kryesisht përmes kontaktit me përfituesit direkt dhe medias sociale fb. i Observatorit: https://www.facebook.com/pg/observator.org.al/posts/?ref=page_internal).

- Me qëllim ngritjen e kapaciteteve te stafit të shkollave për t’u angazhuar në përballjen e ekstremizmit të dhunshëm, janë trajnuar 67 mësues dhe pjestarë të stafit të 3 shkollave pilot si më poshtë:
 - 25 mësues në shkollën e mesme "Mahmud & Ali Cungu" Elbasan
 - 22 mësues në shkollën e mesme "Ibrahim Rugova" Kamza
 - 20 mësues në shkollën e mesme "Dëshmorët e Pojskës" Pogradec
- Po në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të shkollave, është përgatitur në bashkëpunim me ekspertë të MASR dhe IZHA-s një Manual për mësuesit kujdestarë “Në ndihmë të zhvillimit në orë e kujdestarisë të temave mbi parandalimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm me nxënësit e shkollave të mesme”. Manuali ndërmjet të tjerave përmban 4 tema për fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm që do të trajtohen me nxënësit e shkollave të mesme si më poshtë:
 - ✓ Të drejtat e njeriut dhe Toleranca,
 - ✓ Bulizmi si sjellje antishoqërore që çon në dhunë,



- ✓ Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi,
- ✓ Siguria në shkollë.

Manuali është bërë publik në faqen e web-it të Observatorit www.observator.org.al

- Gjatë periudhë kohore Maj – Nëntor 2018 me qëllim formimin e konceptit kundër ekstremizmit të dhunshëm nga nxënësit, mësuesit, prindërit dhe pjestarë të komunitetit, janë realizuar 12 debate publike me pjesëmarrjen e **283** personave. Gjatë këtyre debateve lektorë të ftuar nga institucionet vendore si; policia, institucionet arsimore, përfaqësues të fesë, përfaqësues të qeverisjes vendore, OJQ-të dhe media nëpërmjet trajtimit të temave të ndryshme ndihmuan në shtimin e njohurive dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të pjesëmarrësve mbi fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe tolerancës. Të gjitha aktivitetet janë bërë publike në faqen e web-it të Observatorit www.observator.org.al dhe fb. https://www.facebook.com/pg/observator.org.al/posts/?ref=page_internal.
- Gjatë aktiviteteve të debatit publik, në përgjigje të ngritjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit, studentët e 3 shkollave pilot përgatitën 4 modele fletëpalosje, 3 postera, 1 kolazh me foto dhe 16 ese që shprehin përveçse aftësitë e tyre krijuese edhe perceptimet mbi fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe çfarë duhet të bëhet për ta parandaluar atë. Nxënësit e shkollës së mesme "Ibrahim Rugova" në Kamëz kanë përgatitur gjithashtu një video për bulizmin.
- Gjatë muajit Tetor u realizuan 3 fushata ndërgjegjësuese 1-ditore (nga 1 në secilën shkollë) me pjesëmarrjen e **134** personave. Në zonën e Elbasanit dhe Pogradecit fushatat u realizuan më dt. 2 Tetor që përkon me ditën ndërkombëtare kundër dhunës. Në zonën e Kamzës fushata ndërgjegjësuese u realizua më dt. 9 Tetor.

Çfarë rekomandohet:

- Hartimi i një plani konkret pune të përbashkët të shkollave me institucionet vendore për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj fenomenit të EDH dhe marrjen e masave për parandalimin e tij Ky plan duhet të ketë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e secilit aktor vendor dhe shkolla të jetë në rolin e koordinatores së punës për realizimin e këtij plani.
- Shkolla të punoj më shumë në rritjen e informimit të nxënësve për fenomenin e EDH dhe përballimin e formave të shfaqjes së tij.
- Forcimi i trekëndëshit familje – shkollë – komunitet për përballjen e EDH.
- Shkolla duhet të filloj të mbajë evidenca për rastet e shfaqjes së sjelljeve antishoqërore në shkollë dhe t'i japë mundësi raportimit të rasteve nga nxënësit, mësuesit dhe prindërit.
- Të rritet efektiviteti i punës së grupit psiko-social në shkollë edhe ndaj evidentimit dhe parandalimit të fenomenit të EDH në shkolla.

